

Instituti për Studime të Avancuara GAP

## Letërnjoftimi i Komunës së Istogut 2013

Prill 2013

*“Letërnjoftimi i Komunave”* është projekt i Institutit GAP i cili vlerëson qeverisjen komunale tri vite pas zgjedhjeve lokale të 2009. Ky projekt është implementuar në bashkëpunim me Rrjetin Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) dhe Qendrën e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim (ATRC). Rezultatet e hulumtimeve të GAP për qeverisjen komunale janë debatuar me kryetarët e komunave në emisionet “Jeta në Kosovë”.

## Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive.....	3
1. Hyrje .....	4
2. Problemet në Komunën e Istogut .....	5
3. Performanca buxhetore e Komunës së Istogut .....	6
4. Investimet kapitale .....	12
5. Aktivitetet e Prokurimit Publik .....	15
6. Administrata e Komunës së Istogut.....	17
7. Arsimi në Komunën e Istogut .....	17
8. Transparenca e Komunës së Istogut .....	19
9. Përmbushja e premtimeve të fushatës zgjedhore 2009.....	21
10. Burimet.....	24

## Përmbledhje ekzekutive

Komuna e Istogut që nga zgjedhjet e para lokale të vitit 2000 udhëhiqet nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK). Kryetari aktual i kësaj komune z.Haki Rugova po e përmbyll mandatin e parë katër vjeçar, duke e lenë të hapur mundësin për hyrjen në garë zgjedhore edhe për një mandat të dytë. Paralelisht me ushtrimin e funksionit të Kryetarit, z.Rugova në të njëjtën periudhë ka vetë deklaruar aksione në firmën private "Macon", firmë kjo që nga të dhënat zyrtare rezultojnë që ka marrë tender në Komunë të Istogut për çështje të projekteve në sërë paku dy raste gjatë periudhës 2010-2012. E njëjta firmë ka ndërtuar pallatin gjigant në qendër të qytetit dhe njëherazi ka marrë të drejtën (në fazën e parë) për ndërtimin e Pallatit të Rinisë dhe Sporteve, investim ky nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve (MKRS) i dhënë në kohën kur me këtë ministri ka udhëhequr LDK.

Komuna e Istogut, ndonëse ka përmirësuar dukshëm nivelin e transparencës komunale gjatë tri viteve, ajo nuk i ka ofruar qasje të plotë Auditorit të Përgjithshëm të vendit gjatë auditimit të vitit 2011. Një pjesë e madhe e dokumentacionit të kërkuar për të hyrat komunale nuk i janë ofruar Zyrës së Auditorit. Nuk i janë ofruar as regjistrat e plotë për të hyrat nga licencat e bizneseve, në zyrën urbanizmit dhe kadastrës, zyrës së pronës dhe qirasë, zyrës së taksave administrative dhe participimit të shkollave. Për më shumë, nuk i është ofruar as lista e kontratave të qerases për vitin 2011.

Komuna e Istogut më shumë ka buxhet në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve se niveli i përgjithshëm i të hyrave vjetore që realizon ky institucion. Për mallra dhe shërbime, Komuna e Istogut gjatë vitit 2012 ka pasur në dispozicion mbi 974.000 euro, përderisa për periudhën e njëjtë të hyra komunale janë realizuar 772.000 euro. Rënia e të hyrave nuk është përcjellë edhe me rënien e shpenzimeve. Krahasimi i shpenzimeve mes vitit 2011 dhe atij 2012 rezultojnë me rritje enorme të shpenzimeve gjatë 2012 në shumicën e kategorive. Kësisoj, gjatë vitit 2011 për mirëmbajtjen e veturave janë shpenzuar 27.193 euro, ndërsa në 2012 në të njëjtën kategori rezultojnë të shpenzuara 43.458 euro. Për derivate për automjete në vitin 2011 janë shpenzuar 73.753 euro, ndërsa më 2012 janë shpenzuar 129.512 euro për këtë kategori. Marrë në tërësi, Komuna e Istogut gjatë dy viteve të fundit (2011-2012) vetëm për derivate për automjete ka shpenzuar 203.265 euro, për mirëmbajtjen e veturave gjatë të njëjtës periudhë janë shpenzuar 70.741 euro, për dreka e darka 34.971 euro, për telefona mobil dhe fiks 34.663 euro.

Opozita në Kuvendin komunal ka arritur t'i evidentojë dhe evitojë disa parregullsi dhe keqpërdorime të synuara nga ana e ekzekutivit komunal. Kësisoj, Komuna e Istogut pas pasojave që ka pasur nga era e fuqishme që ka përfshirë këtë komunë në janar të vitit 2012 ka ndarë mjete për banorët e prekur mbi baza të preferencave personale e partiake. Kjo është evidentuar nga një komision i Kuvendit Komunal i cili pas punës në terren ka dorëzuar një raport me rastet e gjetura dhe pas kësaj janë bërë përmirësime nga ana e ekzekutivit.

Në këtë raport, i cili mbulon zhvillimet rreth politikave publike në Komunën e Istogut për periudhën maj 2010 - dhjetor 2012, Instituti GAP ka përmendur problemet më të mëdha me të cilat përballen qytetarët, ka analizuar performancën buxhetore, investimet kapitale, aktivitetet e prokurimit publik, gjendjen në administratë, arsim, transparencën e Komunës, si dhe ka matur realizueshmërinë e premtimeve të dhëna nga Kryetari i Komunës gjatë fushatës zgjedhore të 2010.

## 1. Hyrje

Komuna e Istogut udhëhiqet nga Kryetari Haki Rugova nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK). Z.Rugova e ushtron funksionon e Kryetarit të Komunës nga muaji maj i vitit 2010, apo pas zgjedhjeve të jashtëzakonshme pas vdekjes në detyrë të Kryetarit Fadil Ferati, i cili ushtronte pozitën e Kryetarit të Komunës të fituar në zgjedhjet e rregullta lokale të zhvilluara në nëntor të vitit 2009.<sup>1</sup>

Zgjedhjet e jashtëzakonshme për Komunën e Istogut janë zhvilluar në dy raunde. Haki Rugova kishte siguruar fitoren pas zgjedhjeve në balotazh mes tij dhe Shasivar Haxhiaj (PDK).<sup>2</sup>

Sipas të dhënave të fundit të regjistrimit të popullsisë, Komuna e Istogut ka 39.289 banorë.<sup>3</sup> Para regjistrimit të popullsisë, Komuna e Istogut ka vlerësuar se në këtë komunë jetojnë dyfish më shumë banorë, apo rreth 65.000 banorë.<sup>4</sup> Edhe më tutje, kësaj komune Ministria e Financave i ndan grant qeveritar duke përllogaritur se komuna ka rreth 44.000 banorë.<sup>5</sup>

Ekzekutivi i Komunës së Istogut përbehet nga tetë drejtori. Asnjë Drejtori nuk udhëhiqet nga femrat. Nga 27 asambleistë sa numëron në tërësi Kuvendi Komunal i Istogut vetëm 11 prej tyre janë të LDK. Kjo e ka shtyrë LDK që të hyjë në koalicion me LDD i cili subjekt politik ka tre përfaqësues në Kuvendin Komunal. Subjektet tjera politike të përfaqësuar në Kuvendin Komunal janë: PDK me pesë asambleistë, AAK me gjashtë, AKR me një dhe IRDK (Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës) me një përfaqësues.<sup>6</sup>

---

<sup>1</sup> Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Rezultatet e zgjedhjeve për Kryetar të Komunave. 2009. Fq 7. Burimi: <http://www.kqz-ks.org/SKQZ-WEB/al/zgjedhjetekosoves/materiale/rezultatet2009/kryetar/results%20by%20municipality%20.pdf>

<sup>2</sup> Agjencia e lajmeve "Kosova Press". Haki Rugova shpall fitoren e tij, 9 maj 2010. Burimi: <http://kosovapress.com/?cid=1,26,100143>

<sup>3</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës. Rezultatet përfundimtare për Regjistrimin e Popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave - 2011. Burimi: [http://esk.rks-gov.net/rekos2011/repository/docs/Te%20dhenat%20kryesore\\_ALB.pdf](http://esk.rks-gov.net/rekos2011/repository/docs/Te%20dhenat%20kryesore_ALB.pdf)

<sup>4</sup> Komuna e Istogut. Plani Zhvillimor Komunal i Istogut. Fq 10. Burimi: <http://kk.rks-gov.net/istog/getattachment/f961324e-8e77-44a8-8d18-34caf3f6ab04/PRRU-ISTOG--PJESA-TEKSTUALE-pdf.aspx>

<sup>5</sup> Kuvendi i Kosovës. Ligji për Financat e Pushtetit Lokal. Fq 22. Burimi: [http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2008\\_03-L049\\_al.pdf](http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2008_03-L049_al.pdf)

<sup>6</sup> Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Rezultatet përfundimtare për Kuvendet komunale nga zgjedhjet lokale të vitit 2009. Fq 7. Burimi: <http://www.kqz-ks.org/SKQZ-WEB/al/zgjedhjetekosoves/materiale/rezultatet2009/komune/ResultsByMunicipality.pdf>

## 2. Problemet në Komunën e Istogut

Problemet aktuale në Komunën e Istogut, përveç papunësisë dhe mos zhvillimit ekonomik të cilat konsiderohen probleme nacionale, vlerësohen të jenë edhe uzurpimi i pronës publike, veçmas përgjatë rrjedhjes së lumit “Istog” dhe lumit “Qaush”, si dhe hedhjes së mbeturinave në këta lumenj. Probleme tjera vlerësohen të jenë mbindërtimet në qytet dhe mungesa e shërbimeve adekuate mjekësore në qendrat e shëndetësisë familjare. Komuna e Istogut për dallim nga komunat e tjera nuk i ka aq të theksuara problemet nga mungesa e rrugëve të asfaltuara, mungesa e ujësjellësit dhe kanalizimeve, sepse është punuar gjerësisht në këto kategori gjatë dekadës së fundit.

Shtrati i lumit “Istog” në pjesën dërrmuese të tij është i devijuar nga rrjedhja natyrore dhe kjo ka ardhur nga tendenca e banorëve për të zgjeruar hapësirat përreth shtëpive të tyre. Në një pjesë të konsiderueshme përreth shtratit të lumit ka ndërtime objektsh dhe të gjitha këto janë bërë duke uzurpuar pronën publike. Në Planin Zhvillimor Komunal për Istog ceket se 2% e ndërtesave të banimit janë të ndërtuara në pronën publike.<sup>7</sup> Gjendja e ngjashme paraqitet edhe përgjatë rrjedhës së lumit “Qaush”. Problem tjetër është hedhja e mbeturinave në shtratin e lumit. Autoritetet komunale janë përpjekur disa herë që të parandalojnë këtë dukuri, por edhe përkundër kësaj rezultatet në terren nuk kanë qenë inkurajuese.

Problem tjetër i cili ka përcjellë gjatë tri viteve të fundit Komunën e Istogut janë edhe mbindërtimet e ndryshme që behën në ndërtesa kolektive. Në disa raste autoritetet komunale kanë lëshuar leje përkatëse ndërtimi për këto mbindërtime, por disa sosh konsiderohen ilegale.

Komuna e Istogut është e njohur edhe për resurset e mira që ka në zhvillimin e turizmit malor. Por Komuna, me përjashtim të rregullimit të rrugëve, nuk ka ndërmarrë ndonjë hap tjetër në sensibilizimin dhe forcimin e sektorit të turizmit. Kjo besohet që do të ndikonte edhe në zhvillimin e bizneseve në zonat malore të kësaj komune dhe në mos zhvendosjen e popullatës nga zonat rurale drejt atyre urbane. Zonat me të njohura për resurset turistike malore në Komunën e Istogut vlerësohen lokaliteti i Lugut të Butë (Koreniku, Çorovoda, Oshlaku, Gurrat e Bardha, Lugu i Zajmit) dhe lokaliteti i Moknës (Livadhet e Istogut, Bajsha, Radusha, Mokna, Kosharishtja).

Autoritetet komunale të Istogut nuk kanë arritur t’i mënjanojnë disa nga problemet të cilat vetë i kanë identifikuar si të tilla. Në qendër të Istogut, skaj çerdhes publike “Gëzimi Ynë” gjendet pompa e benzinës. Ndonëse disa herë kjo është vlerësuar me rrezikshmëri të lartë, asnjëherë nuk është ndërmarrë ndonjë veprim në largimin e saj.

---

<sup>7</sup> Komuna e Istogut. Plani Zhvillimor Komunal i Istogut. Fq 22. Burimi: <http://kk.rks.gov.net/istog/getattachment/f961324e-8e77-44a8-8d18-34caf3f6ab04/PRRU-ISTOG--PIESA-TEKSTUALE-pdf.aspx>

Problem në Komunën e Istogut paraqet edhe zhurma nga muzika e lartë e lokaleve hoteliere të cilat kryesisht janë të koncentruara në qendër të qytetit dhe të hapura poshtë ndërtesave publike. Banorët e këtyre zonave, veçmas ata që banojnë përgjatë rrugës “2 Korriku” disa herë radhazi iu kanë drejtuar Komunës me kërkesën e rregullimit të orarit të punës dhe zvogëlimin e zhurmës. . Deri tani nuk është ndërmarr ndonjë masë qoftë juridike, qoftë praktike në adresimin e kësaj çështje nga autoritetet komunale.

### 3. Performanca buxhetore e Komunës së Istogut


Gjatë një viti, Komuna e Istogut ka në dispozicion mbi 8 milionë euro buxhet. Në këtë shumë bëjnë pjesë të hyrat vetanake, ndërsa pjesa tjetër e buxhetit përbëhet nga granti i Qeverisë së Kosovës për komuna, nga granti specifik për arsim dhe shëndetësi, si dhe nga qarkorja e programuar për paga.

Tabela nr.1: Buxheti i përgjithshëm i Komunës së Istogut gjatë tri viteve

Kategoria	2013	2012	2011
Investime Kapitale	2.533.859	1.960.357	2.458.136
Mallra dhe shërbime	871.138	974.413	603.683
Subvencion dhe transfere	450.000	327.285	117.585
Shpenzime komunale	164.920	150.258	131.276
Paga	4.366.810	4.394.838	4.206.560
<b>Totali</b>	<b>8.386.727</b>	<b>7.807.166</b>	<b>7.517.240</b>

Komuna e Istogut më shumë ka buxhet në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve se niveli i përgjithshëm i të hyrave vjetore që realizon ky institucion. Kësisoj për mallra dhe shërbime, Komuna e Istogut gjatë vitit 2012 ka pasur në dispozicion mbi 974 mijë euro, përderisa për periudhën e njëjtë të hyra komunale kanë realizuar në vlerën e mbi 772 mijë euro. Niveli i të hyrave komunale ka shënuar rënie në krahasim me vitet paraprake, përderisa shkalla e mjeteve të dedikuara në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve ka shënuar rritje të shpejtë.

Grafikoni nr.1: Të hyrat komunale në Istogut gjatë katër viteve të fundit



Gjatë vitit 2012 ka pasur 36.576 euro më pak të hyra se gjatë vitit 2011. Të hyrat komunale për vitin 2012 nuk kanë përmbushur as përafërsisht planifikimet e kësaj komune në këtë drejtim pasi që ishin planifikuar 869.580 euro.<sup>8</sup>

Tabela: nr.2: Pasqyrimi i të hyrave komunal gjatë vitit 2012 sipas sektorëve dhe krahasimi i tyre me vitin 2011


Linja e të hyrave	Shuma (euro)	
	2012	2011
Nga certifikatat e lindjes	35.519	40.000
Nga certifikatat e martesës	8.743	10.000
Nga certifikata e vdekjes	567	1.000
Certifikata tjera zyrtare	14.659	17.000
Verifikimi i dokumenteve	3.200	3.000
Tatimi administrativ & shërbimet publike	9.126	4.000
Tatim për pjesëmarrje në tender	1.580	2.000
Tatim nga përdorimi i pronës publike	3.818	7.000
Inspektimi në terren dhe matje	58.564	57.000
Tatimi në pronë	236.068	220.000
Qiraja për objekte publike	3.756	6.000
Licenca për biznes dhe tatim në	18.786	17.000

<sup>8</sup> Të dhënat për të hyrat e vitit 2012 janë siguruar nga biseda me Drejtorinë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim i Komunës së Istogut Qazim Loxha. Biseda është zhvilluar me datë 13.03.2013.

afarizëm		
Licenca individuale	2.355	8.000
Licenca për shërbime profesionale	12.690	12.000
Licenca për shitje në hapësirat publike	4.403	4.000
Licenca për lojërat e fatit	430	1.000
Licenca për shitje me pakicë të vajrave	2.496	3.000
Licenca për dyqane të mëdha	870	00
Tatim për regjistrimin e automjeteve	57.452	60.000
Tatimi për dislokimin të tokës	3.700	1.000
Participimi në Arsim dhe Shëndetësi	92.229	90.000
Gjoha nga trafiku	25.518	29.000
Gjobat nga gjykatat	85.035	98.000
Tatimi i pylltarisë	20.722	17.000
Licenca për hoteleri	2.000	8.000
Të hyra nga lejet e ndërtimit	68.327	94.000
<b>Totali</b>	<b>772.613</b>	<b>809.000</b>

Komuna e Istogut në raportet financiare i ka kategorizuar si të hyra edhe participimet e qytetarëve me të holla në projektet e ndryshme bashkë financimi mes komunës dhe komunitetit. Për vitin 2011, Komuna e Istogut në raportin e saj të hyra ka prezantuar në vlerë prej 855.000 euro, duke përfshirë edhe 46.000 euro si të hyra nga komuniteti. Kjo përfshirje e bëra nga ana e Komunës së Istogut nuk është pranuar nga ana e Ministrisë së Financave të Qeverisë së Kosovës e cila në raportin zyrtar për vitin 2011 paraqet shifrën e të hyrave për Komunën e Istogut në vlerë prej 809.000 eurove.

Grafikoni nr.2: Shuma e buxhetit në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve në tri vitet e fundit në Komunën e Istogut





Auditorit i Përgjithshëm të rasti i Istogut nxjerr vërejtje për nivelin e bashkëpunimit që ka pasur me Komunën e Istogut. Një pjesë e madhe e dokumentacionit të kërkuar për të hyrat komunale nuk i janë ofruar Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm. Komuna e Istogut nuk i ka ofruar auditorit një regjistër të detajuar dhe të plotë për të hyrat nga licencat e bizneseve, në zyrën e urbanizmit dhe kadastrës, zyrës së pronës dhe qirasë, zyrës së taksave administrative dhe participimit të shkollave. Për më shumë nuk i është ofruar as lista e kontratave të qerasë për vitin 2011.<sup>9</sup>

Tabela nr.3: Vlerësimi i shpenzimeve (në euro) në disa kategori në linjën për mallra dhe shërbime dhe shpenzimeve komunale sipas periudhave të vitit - 2011

Kategoria	Janar - Qershor	Korrik - Shtator	Tetor - Dhjetor	Totali
Derivate për vetura	25.017	29.438	19.298	<b>73.753</b>
Telefoni mobile	3.174	1.455	2.804	<b>7.433</b>
Riparimi i automjeteve	11.931	8.432	6.830	<b>27.193</b>
Darka zyrtare	5.375	3.638	6.596	<b>15.609</b>
Për energji elektrike	33.480	7.878	17.236	<b>58.594</b>
Pagesa për uji	8.486	5.465	37.686	<b>51.637</b>
Pagesa për mbeturina	3.272	2.099	5.449	<b>10.820</b>
Mirëmbajtja e pajisjeve	5.665	2.920	4.686	<b>13.271</b>

Tabela nr.4: Shpenzimet në disa kategori (në euro) në linjën për mallra dhe shërbime në Komunën e Istogut për periudhën janar -dhjetor të vitin 2012

Kategoria	2012
Udhëtime dhe mëditje për udhëtime jashtë vendit	8.956
Shpenzime në telefonin mobile	8.199
Shpenzime në telefonin fikse	9.830
Mirëmbajtja e teknologjisë informative	5.261
Shpenzime -naftë për ngrohje	38.191
Blerja e druve për ngrohje	71.381
Blerje e thëngjillit për ngrohje	27.363
Derivate për gjenerator	9.073
Karburant për vartura	129.512
Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve	43.548
Mirëmbajtja e ndërtesave	258.257
Dreka dhe darka zyrtare	19.362
Mirëmbajtja e objekteve arsimore	38.761
Mirëmbajtja e objekteve shëndetësore	10.360
Mirëmbajtja e mobileve dhe pajisjeve	16.535

<sup>9</sup> Zyra e Auditorit të Përgjithshëm. Raporti i Auditimit Financiar për Komunën e Istogut. 2011. Fq-12. Burimi: [http://www.oag-rks.org/repository/docs/Raporti\\_Istog\\_ALB\\_me\\_PVF\\_491736.pdf](http://www.oag-rks.org/repository/docs/Raporti_Istog_ALB_me_PVF_491736.pdf)

Komuna e Istogut, pagesat e bëra për sanimin e dëmeve të shkaktuara nga era e fuqishme që ka përfshirë këtë lokalitet në janar të 2012, i ka kategorizuar në raportin e buxhetit si investime në mirëmbajtjen e ndërtesave, brenda kategorisë së mallrave dhe shërbimeve.<sup>10</sup> Kështu, për mirëmbajtjen e ndërtesave në vitin 2011 janë shpenzuar 7.657 euro, në vitin 2012 në të njëjtën kategori janë shpenzuar 258.257 euro. Rritje gjatë vitit 2012 ka rezultuar të këtë edhe kategoria e shpenzimit të parave për derivate për vetura si dhe naftë për ngrohje. Kështu, gjatë tërë vitit 2011 derivate për vetura janë shpenzuar 73.753 euro, përderisa në vitin 2012 janë shpenzuar 129.512 euro. Njësoj rritje të theksuar ka shënuar kategoria e riparimit dhe mirëmbajtjes së veturave zyrtare. Gjatë tërë vitit 2011 në këtë kategori janë shpenzuar 27.193 euro, ndërsa gjatë vitit 2012 janë shpenzuar 43.548 euro.

Tabela nr.5: Vlerësimi i shpenzimeve (në euro) në disa kategori në linjën për mallra dhe shërbime dhe shpenzimeve komunale sipas periudhave të vitit - 2012

Kategoria	Janar - Qershor	Korrik - Shtator	Tetor - dhjetor	Totali
Derivate për vetura	50.378	55.025	24.109	129.512
Telefoni mobile	3.561	3.449	1.189	8.199
Riparimi i automjeteve	22.913	8.372	12.263	43.548
Darka zyrtare	9.310	2.634	7.418	19.362
Për energji elektrike	40.014	10.697	21.149	71.860
Pagesa për ujë	10.022	6.014	35.105	51.141
Pagesa për mbeturina	5.184	4.307	3.110	12.601

Tabela nr.6: Shpenzimet (në euro) në disa kategori në linjën për mallra dhe shërbime në Komunën e Istogut dhe krahasimi mes vitit 2012 dhe 2011 dhe vlerësimi i diferencës në rritje (+) apo në rënie (-) mes 2012 dhe 2011

Kategoria	2011	2012	Totali	Diferenca + ose -
Mëditje për udhëtime jashtë vendit	4.048	8.956	13.004	+ 4.908
Shpenzime në telefonin mobile	7.433	8.199	15.632	+ 766
Shpenzime në telefonin fikse	9.201	9.830	19.031	+ 629
Mirëmbajtja e mobileve dhe pajisjeve	13.271	16.535	29.806	+ 3.264
Shpenzime -naftë për ngrohje	6.781	38.191	44.972	+ 31.410
Blerja e druve për ngrohje	52.886	71.381	124.267	+ 18.495
Blerje e thëngjillit për ngrohje	30.816	27.363	58.179	- 3.453
Derivate për gjenerator	6.035	9.073	15.108	+ 3.038
Karburant për vartura	73.753	129.512	203.265	+ 55.759
Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve	27.193	43.548	70.741	+ 16.355

<sup>10</sup> Komuna e Istogut. Bisedë me zyrtarin financiar në Drejtorinë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim, Osman Sadikaj. Biseda është zhvilluar me date 10.04.2013.

Mirëmbajtja e ndërtesave	7.657	258.257	265.914	+ 250.600
Dreka dhe darka zyrtare	15.609	19.362	34.971	+ 3.753
Mirëmbajtja e objekteve arsimore	32.163	38.761	70.924	+ 6.598
Mirëmbajtja e objekteve shëndetësore	7.949	10.360	18.309	+ 2.411

Krahasimi i shpenzimeve të vitit 2012 dhe vitit paraprakë (2011) rezulton me rritjen e shpenzimeve në të gjitha kategoritë, me përjashtim të blerjes së thëngjillit për ngrohje. Rritje më të madhe të shpenzimeve janë hasur në kategorinë e derivateve për vetura, blerjes së druve për ngrohje, naftë për ngrohje, riparimit të automjeteve si dhe shifra më e lartë e hasur është ajo për mirëmbajtjen e ndërtesave.<sup>11</sup>

Tabela nr.7: Prezantimi i shpenzimeve (në euro) në linjën e shpenzimeve komunale për vitin 2012 dhe krahasimi me vitin 2011

Kategoria	2012	2011
Pagesat për energji elektrike	71.860	58.594
Pagesat për ujë	51.414	51.637
Pagesat për mbeturina	12.601	10.820

Komuna e Istogut, pas pasojave që ka pasur nga era e fuqishme, ka formuar një komision komunal për evidentimin dhe kompensimin e pjesëm të dëmeve. Ky komision u formua nga Kuvendi Komunal pas kërkesave të partive opozitare në Kuvend të cilat kanë paraqitur të dhëna që ndarja e mjeteve dhe tjegullave për familjet e prekura nga era po bëhet mbi baza të preferencave politike e personale të ekzekutivit komunal. Kjo ka ardhur pasi përfitues nga kompensimet kanë dal të jenë edhe zyrtarët komunal si Drejtori i Shërbimeve Publike në Komunë të Istogut Bedri Hasani i cili supozohet të këtë marrë disa herë radhazi tjegulla për shtëpinë e tij dhe për shtëpitë e vëllezërve të tij.<sup>12</sup> Dëmet që ka llogaritur komisioni komunal kapin shifrën e afro 6 milionë eurove. Komuna ka ndarë 197 mijë euro, kurse Qeveria e Kosovës afro 300 mijë euro. Komisioni i Kuvendi ka paraqitur raportin me datë 28.05.2012. Ky komision është udhëhequr nga asambleisti i PDK në Kuvend, Lulzim Shoshi, i cili ka prezantuar të dhëna që argumentonin ndarjen e ndihmave mbi baza partiake dhe të ndërlidhura me afërsi familjare. Në vlerësim të Komisionit thuhet se ka të gjetura se disa shtëpi kanë marrë tjegulla, ndonëse shtëpitë i kanë pasur paraprakisht të mbuluara me llamarinë

<sup>11</sup> Mirëmbajtja e ndërtesave nënkupton ekskluzivisht mirëmbajtjen e tyre, respektivisht pastrimin. Me mirëmbajtje nuk nënkuptohet rregullimi infrastrukturor, ngase kjo formë e investimeve kategorizohet të linja për investime kapitale. Në kategorinë për mirëmbajtja hyjnë, mirëmbajtja e automjeteve dhe riparimi i tyre, mirëmbajtja e ndërtesave administrative dhe komunale, mirëmbajtja e objekteve arsimore, mirëmbajtja e objekteve shëndetësore, mirëmbajtja e mobileve dhe pajisjeve ku hyjnë edhe teknologjia informative si dhe mirëmbajtja e rrugëve.

<sup>12</sup> Komuna e Istogut. Kuvendi Komunal. Procesverbali nga mbledhja e Kuvendit Komunal të Istogut. Nr 28. Datë 31.01.2012. Numri rendor në faqen zyrtare te komunës 2/23/2012/2:58. Burimi: <http://kk.rks.gov.net/istog/Municipality/Seances.aspx>

dhe po ashtu janë hasur raste kur përfitues të tjegullave janë përmendur persona të cilëve nuk iu janë ofruar tjegulla.<sup>13</sup>

#### 4. Investimet kapitale

Shuma e përgjithshme e mjeteve që ka në dispozicion Komuna e Istogut gjatë një viti për investime kapitale sillet rreth 2.5 milionë euro. Këto investime kanë pasur për fokus rregullimin e rrugëve që përfshijnë rehabilitimin, asfaltimin dhe pjesërisht ndriçimin e tyre, investimet në disa objekte kulturore dhe në objektet administrative dhe ato arsimore.

Tabela nr.8: Pasqyrimi i investimeve më të mëdha të Komunës së Istogut në linjën e investimeve kapitale gjatë vitit 2012, 2011 dhe 2010

Projektet kryesore të realizuara gjatë 2012	Shuma (euro)
Asfaltimi i rrugëve lokale në zonën e quajtur Gurrako	71.000
Asfaltimi i rrugëve lokale në Banjë	32.200
Asfaltimi i rrugës Suriganë	45.000
Ndërtimi i urës në Rakosh	6.300
Asfaltimi i rrugës në Shushicë "Faza e dytë"	24.987
Ndërtimi i urës në Zhakovë	5.900
Asfaltimi i rrugëve në Rakosh	33.066
Asfaltimi i rrugës në relacionin për Dreje	74.831
Asfaltimi i rrugës në precall	20.000
Rregullimi i kanalizimit në Tomoc	13.920
Rregullimi i kanalizimit fekal në fshatin Lobovë	20.985
Rregullimi i kanalizimit fekal në fshatin Gurrakoc	33.811
Ndërtimi i gropës septike dhe kanalizimit në Cerricë	9.969
Rregullimi i përroit në fshatin Cerricë	49.759
Ndërtimi i qendrës rinore në fshatin Dobrushë	62.210
Asfaltimi i rrugës në relacionin Burim - Istog	114.786
Ngritja e murit mbrojtjes në pendën e Dobovës	14.974
Rregullimi i rrugës "Bajram Gashi"	21.231
Ndërtimi i shtëpisë për të pastrehët	49.447
Aneksi i objektit komunal të Istogut	97.145
Projektet kryesore të realizuara gjatë 2011	Shuma (euro)
Asfaltimi i rrugës në Shushicë "Faza e parë"	242.506
Asfaltimi i rrugës për në Dobovë	31.320

<sup>13</sup> Komuna e Istogut. Kuvendi Komunal. Procesverbali nga mbledhja e Kuvendit Komunal të Istogut. Nr 33. Datë 28.05.2012. Numri rendor në faqen zyrtare të komunës 6/25/2012/7:06. Burimi: <http://kk.rks.gov.net/istog/Municipality/Seances.aspx>

Asfaltimi i rrugës për në Orroberd	156.260
Ndërtimi i kanalizimit në Tomoc "Faza e tret"	49.428
Renovimi i tribunës së stadiumit të qytetit	2.980
Rregullimi i rrugës së qytetit - lagjja "Osmanaj"	51.175
Hapja e rrugës në fshatin Zhakovë	12.660
Rregullimi i rrugëve, trotuarit dhe kanalizimit në Banjë	81.587
Gëlqerosja e objekteve të banimit kolektiv në Istog	92.195
Asfaltimi i rrugës të zona e quajtur 'pompas e ujit'	60.835
Asfaltimi i rrugës në Dushkaj	35.960
Asfaltimi i rrugës në Corrolluk - lagjja "Podrimaj"	37.375
Asfaltimi i rrugës në Orroberd - lagjja "Mirana"	27.493
Rregullimi i rrugës "Bujar Visoqi"	31.958
Ndërtimi i katit të objektit komunal në Istog	256.231
Asfaltimi i rrugës në afërsi të pallatit të kulturës	42.470
Asfaltimi i rrugës në relacionin e varrezave të Dushkajës	45.323
Asfaltimi i rrugës "Gazmend Zajmi"	18.528
Asfaltimi i rrugës "Srebrenica"	26.263
Rregullimi i rrugës malore Lugu i but - Shushan	34.490
<b>Projektet kryesore të realizuara gjatë 2010</b>	<b>Shuma (euro)</b>
Hapja e deponis së mbeturinave në Tuqep	9.996
Asfaltimi i rrugës "Mehmet Akif"	32.750
Asfaltimi i rrugës në afërsi të shkollës në fshatin Banjë	8.991
Rregullimi i ujësjellësit në fshatin Kaliqan	39.960
Ndërtimi i ujësjellësit në fshatrat Osojan dhe Shalinovic	82.771
Riparimi i përgjithshëm i objektit të komunës	36.151
Rregullimi i kanalizimit përgjatë zonës së tregut	46.763
Asfaltimi i rrugës në zonën e Istogut të poshtëm	159.671
Ndërtimi i murit mbrojtës në rrugën "Fehmi Agani"	3.195
Asfaltimi i rrugës "Lugu" në Istog	137.653
Asfaltimi i rrugës në Istog lagjja "Gecaj"	101.754
Ndërtimi i ujësjellësit në Llukavc	68.517
Ndërtimi i kanalizimit në Muzhevinë	214.463
Asfaltimi i rrugës në fshatin Kerninë	139.850
Ndërtimi i kanalizimit në fshatin Zallq	37.464

Vëllezërit e kryetarit Haki Rogova përfaqësojnë kompaninë e ndërtimit "Macon". Nisja e objektit për ndërtimin e palestrës sportive në Istog (financim i MKRS-se dhe donatorëve ndërkombëtar) në fazën e parë është bërë nga kjo firmë në vitin 2006-2007. Po ashtu e njëjta firmë ka ndërtuar pallatin shumëkatësh në qendër të qytetit në rrugën "2 Korriku" (objekt privat) i cili në rajonin e Istogut njihet me emrin "pallati i rugovianeve". E njëjta firmë ka marrë të drejtën për projektimin e vijës së kanalizimit për tri fshatra të Komunës së Istogut, e drejtë kjo e dhënë nga Komuna e Istogut në

kohën kur në krye të komunës ka ardhur Haki Rugova.<sup>14</sup> E njëjta kompani haset të këtë fituar tender në komunë edhe gjatë vitit 2010 në sferën e projektimit të planeve për ujësjellës.<sup>15</sup> Në deklarin e pasurisë në Agjencinë Kundër Korrupsion (2012), Kryetari i Istogut ka vetë-deklaruar 15% aksione në firmën “Macon”.<sup>16</sup>

Rexhep Blakaj zyrtar në drejtorin e Urbanizimit në Komunë të Istogut e ka të hapur edhe një firmë projektuese (Arch-Art) në Istog e cila udhëhiqet nga djali i tij Gezim Blakaj dhe punët kryesore të projektimit në komunë i merr mbi veti për t’i punuar nëpërmjet procedurave të prokurimit. Një nga to është dhënë për hartimin e projektit për gëlqerosjen e ndërtesave publike në Komunë të Istogut. Kontrata është lidhur me datë 16.12.2011.<sup>17</sup> E njëjta kompani private ka projektuar një pjesë të planit për kopshtin e fëmijëve në Istog.<sup>18</sup>

Tabela nr.9: Disa nga projektet e parapara për t’u realizuar gjate këtij vitit (2013) nga Komuna e Istogut

Projektet e parapara për 2013	Shumat e ndara (euro)
Ndërtimi i garazheve te komunës për veturat zyrtare	15.000
Ndërtimi i kanalizimit në fshatin Gurrakoc	35.000
Ndërtimi i kanalizimit në fshatin Staradaran-II	45.000
Ndërtimi i Shtëpive për familjet e pa strehë	70.000
Riparimi i rrugëve me asfalt i fshatrave Llukavc	10.000
Asfaltimi i rrugës në Veric	50.000
Ndërtimi i kanalizimit në fshatin Dobrushë	5.000
Rregullimi i perroit vërshues në Cercë	50.000
Hapja e rrugës malore Kaliqan-Lugu i madh	30.000
Asfaltimi i rrugës në fshatin Moistir	100.000
Asfaltimi i rrugës Shushice/Lagja Salihaj/	35.000
Asfaltimi i rrugës në Istog/lagja Alihajdaraj/	40.000
Asfaltimi i rrugës për fshatin Prekalle	20.000
Rregulimi i shtratit të lumit Qaush në Istog	50.000
Renovimi i Objektit nr II të Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare	25.000
Ndërtimi i Zyrës së vendit në fshatin Gurrakoc	30.000

<sup>14</sup> Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik. Njoftimet e shpallura për dhënien të tenderit. 2011. Komuna e Istogut. Burimi: <https://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=-1&CtlID=ViewNotices&ID=40139>

<sup>15</sup> Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik. Njoftimet e shpallura për dhënien të tenderit. 2011. Komuna e Istogut. Burimi: <https://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=-1&CtlID=ViewNotices&ID=31587>

<sup>16</sup> Agjencia Kundër Korrupsionit. Deklarimi i Pasurisë. 2012. Komuna e Istogut. Haki Rugova. Burimi: [http://akk-ks.org/2012/Komunat/Komuna\\_e\\_Istogut/Haki\\_Rugova.pdf](http://akk-ks.org/2012/Komunat/Komuna_e_Istogut/Haki_Rugova.pdf)

<sup>17</sup> Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik. Njoftimet e shpallura për dhënien të tenderit. 2011. Komuna e Istogut. Burimi: <https://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=-1&CtlID=ViewNotices&ID=52872>

<sup>18</sup> Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik. Njoftimet e shpallura për dhënien të tenderit. 2011. Komuna e Istogut. Burimi: <https://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=-1&CtlID=ViewNotices&ID=37067>



Ndërtimi i kanalizimit në fshatin Dobrushë	39.000
Asfaltimi i rrugës në Zablaq - lagjja Balaj	10.000
Ndërtimi dhe rregullimin i trotuareve në rrugën "2 Korriku"	20.000
Asfaltimi i Rrugës Nikolla Tesla në Istog	15.000

## 5. Aktivitetet e Prokurimit Publik

Komuna e Istogut fushën e prokurimit publik e ka të rregulluar në nivel të zyrës e cila sipas organo-gramit funksionin brenda Drejtorisë së Administratës. Kjo zyre ka dy person të punësuar, njeri nga të cilët mban edhe pozitën e menaxherit të Zyrës së Prokurimit. Për tri vite (2010-2012) Komuna e Istogut ka lidhur afro 400 kontrata nëpërmjet procedurave të prokurimit publik, me një vlerë të kontratave afro 7 milionë euro.

Tabela nr.10: Kontratat e Prokurimit në Komunën e Istogut 2010 -2012

Viti	Nr. i kontratave	Vlera e kontratave (euro)
2010	142	2.756.224,12
2011	128	2.701.633,27
2012	61	1.458.253,08
<b>Totali</b>	<b>331</b>	<b>6.916.110,47</b>

Për vitin 2012 të dhënat përfshijnë vetëm njoftimet e KRPP

Në tri vitet e fundit (2010 – 2012) ndaj komunës së Istogut në Organin Shqyrtues të Prokurimit Publik janë adresuar gjithsej pesë ankesa. Numri i ankesave nuk rezulton të jetë i madh, duke marrë për bazë numrin relativisht të madh të kontratave të lidhura me procedurë të prokurimit publik. Nga pesë ankesat e adresuara në OSHP, vetëm njëra prej tyre është cilësuar nga OSHP-ja si pjesërisht e bazuar, ndërkaq të tjerat janë cilësuar si ankesa të pabaza dhe si të tilla vendimi OSHP ka qenë në favor të Komunës së Istogut.<sup>19</sup>

Në disa raste autoritetet e Istogut nuk janë treguar argumentues dhe transparent në respektimin e procedurave gjatë marrjes së vendimeve të caktuara. Kësisoj, Vetura e tipit “Mercedes Benz” që është blerë nga Komuna e Istogut në kohën e ish-kryetarit i ndjerë Fadil Ferati në vlerë prej 21.000 eurosh, tash vozitet nga djali i tij Ilir Ferati. Ekzekutivi i Istogut nuk e ka marrë veturën nga oborri i ish kryetarit Ferati me

<sup>19</sup> Organi Shqyrtues i Prokurimit. Vendim 234/2011. Data:27.09.2011. Burimi: [http://oshp.rks.gov.net/repository/docs/vendimet/2011/furnz\\_ushqim\\_higjen\\_shtat11.pdf](http://oshp.rks.gov.net/repository/docs/vendimet/2011/furnz_ushqim_higjen_shtat11.pdf)

arsyetimin se kjo mund ta lëndojë familjen e të ndjerit. Zyrtarët komunal të Istogut arsyetohet se kjo çështje është rregulluar përmes ankandit publik, por nuk kane ofruar dëshmi se kur është mbajtur ankandi publik, sa persona/subjekte kanë qenë të interesuar të blejnë atë veturë dhe po ashtu nuk dihet për vlerën eventuale të shitjes së veturës.<sup>20</sup>

Komuna e Istogut në fund të vitit 2012 ka kontraktuar blerjen e tri automjeteve të vjetra për heqjen e borës nga rrugët e qytetit. Kjo blerje, e cila buxhetit të komunës i ka kushtuar mbi 36.000 euro, bëhet në kohën kur Komuna për çdo vit kontraktonte kompani private për mirëmbajtjen dimërore të rrugëve.<sup>21</sup>

Komuna e Istogut gjatë tri viteve të fundit ka shpenzuar të holla të konsiderueshme në zgjerimin, forcimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit energjetik. Këto investime janë hasur më së shumti gjatë vitit 2010 dhe atij 2011, por investime në të njëjtin sektor nga Komuna e Istogut janë paraparë të realizohen edhe në vitin 2013 edhe përkundër faktit që tani Qeveria e Kosovës e ka shitur rrjetin shpërndarës të energjisë konsorciumit turk “Limak & Çalik”. Komuna ka investuar në rrjetin shpërndarës të rrymës i cili rrjet është aset i KEK-ut dhe jo i komunave. Shtyllat elektrike, trafot e rrymës dhe kabllot deri në shtyllë elektrike të gjitha janë asete të KEK-ut, mirëmbahen, kontrollohen dhe do të duhej zëvendësohen nga kjo korporatë. Nga ana tjetër, komunat në vazhdimësi e paguajnë KEK-un për shfrytëzimin e shtyllave elektrike për vendosjen e poqëve të ndriçimit publikë. Ani pse KEK-u nuk i paguan komunat për faktin se shtyllat elektrike dhe trafot janë të vendosura në pronat komunale, shoqërore dhe ato private.

Gjatë kësaj periudhe (2010 -2013) janë investuar nga Komuna e Istogut mbi 115.000 euro në rrjetin energjetik. Rastet e evidentuara janë:

1. Riparimi i rrjetit elektrik në fshatin Muzhevina – vlera 14.364 euro.
2. Ndërtimi i trofove në Dobrushë, Llukavc, Kaliqan, lagja Shkoza” - vlera 24.647,50 euro
3. Ndërtimi i trafos në lagjen Bardheci dhe Gecaj në fshatin Muzhevina. Vlera 21.522.
4. Ndërtimi i trafos elektrike në Banjë. Vlera 15.055,03 euro.
5. Ndërtimi i trafos për fshatin Lluga. Vlera 20.000 euro. Investim ky që është parapare të bëhet gjatë këtij vitit (2013).
6. Ndërtimi i trafos për fshatin Saradran. Vlera 20.000 euro. Investim ky që është paraparë të bëhet gjatë këtij vitit (2013).

---

<sup>20</sup> Agjencia e lajmeve “Telegraf”. Datë 07.10.2011. Mercedesi i Komunës së Istogut trashëgohet nga djali i ish Kryetarit. Burimi: <http://www.telegrafi.com/lajme/jamercedesija-i-komunes-se-istogut-trashegohet-nga-djali-i-ish-kryetarit-2-17528.html>

<sup>21</sup> Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik. Njoftimet e shpallura për dhënien të tenderit. 2012. Komuna e Istogut. Burimi: <https://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=-1&CtlID=ViewNotices&ID=65590>



## 6. Administrata e Komunës së Istogut

Komuna e Istogut ka gjithsej 157 persona të punësuar në administratën komunale, të punësuarit në Qendrën për Punë Sociale dhe në institucionet kulturore të qytetit. Ky numër ka qenë për 12 persona më shumë, por gjatë fundit të vitit 2012, qendra e zjarrfikëseve ka kaluar nga kompetencat komunale në menaxhimin e MPB, përkatësisht sektorit për emergjenca civile. Ndërsa së bashku me sektorin e arsimit, ku përfshihen të punësuarit në çerdhet e qytetit, në shkollat fillore dhe ato të mesme si dhe në sektorin e shëndetësisë, numri i të punësuarve në institucionet publike komunale është 941 persona.

Tabela nr.11: Numri i të punësuarve sipas sektorëve në Komunën e Istogut dhe vështirimi gjinor

Sektorët	Numri i të punësuarve	M	F
Zyra e Kryetarit	8	7	1
Drejtorja e Administratës Komunale	44	31	13
Drejtorja për Financa, Ekonomi dhe zhvillim	23	15	8
Drejtorja e Urbanizimit	14	13	1
Drejtorja e Inspektionit	7	6	1
Drejtorja e Arsimit, Kulturës, Rinise dhe Sportit	8	6	2
Drejtorja e Shëndetësisë dhe QPS	13	8	5
Drejtorja për Bujqësi dhe Pylltari	19	19	0
Drejtorja e Shërbimeve Publike	8	8	0
Zyra për Komunitete	7	6	1
Shtëpia e Kulturës në Istog	6	4	2
<b>Gjithsej</b>	<b>157</b>	<b>123</b>	<b>34</b>

Numri i përgjithshëm i femrave të punësuar në dikasteret e komunës del të jetë shumë i vogël. Kësisoj, nga 157 të punësuar si shërbyes civil, vetëm 34 prej tyre janë femra. Numri i femrave të punësuar është i vogël edhe në sistemin arsimor dhe atë shëndetësor të kësaj komune.

## 7. Arsimi në Komunën e Istogut

Gjatë tri viteve të kaluara, Komuna e Istogut investime në shkolla i ka fokusuar në riparime të ndryshme. Një mori investimesh në arsim kanë qenë të mbështetura financiarisht edhe nga ana e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) dhe nga donatorët e ndryshëm. Komuna e Istogut ka pesë çerdhe publike. Numri i çerdheve në këtë komunë rezulton të jetë i kënaqshëm, për dallim nga disa komuna

tjera të vendit. Istogu më me pak se 40 mijë banorë, ka çerdhe më shumë se Rahoveci e cila me afro 60 mijë banor ka vetëm një çerdhe, apo Vushtrria me afro 70 mijë banorë e cila po ashtu ka vetëm një çerdhe publike. Komuna e Istogut po ashtu numëron 25 shkolla fillore dhe tri shkolla të mesme.

Tabela nr.12: Numri i fëmijëve dhe i personelit në pesë çerdhet e Istogut dhe vështrimi gjinor

Numri i fëmijëve	F	M	Numri i edukatoreve	F	M	Personeli ndihmës	F	M
234	118	116	15	15	0	23	8	15

Tabela nr.13: Numri i mësimdhënësve dhe stafit përcjellës në 25 shkollat fillore dhe tri shkolla të mesme të Istogut:

Gjinia	Shkolla fillore		Shkolla të mesme	
	Mësimdhënës	Stafi ndihmës	Mësimdhënës	Stafi ndihmës
Femra	205	11	30	3
Meshkuj	183	94	79	13
<b>Gjithsejtë</b>	<b>388</b>	<b>105</b>	<b>109</b>	<b>16</b>

Tabela nr.14: Numri total i mësimdhënësve, nxënësve dhe stafit ndihmës në 25 shkolla fillore dhe tri shkolla të mesme në Komunën e Istogut

Kategoria	Numri	F	M
Mësimdhënës	497	235	262
Nxënës	9.019	4.211	4.808
Stafi ndihmës	121	14	107

Tabela nr.15: Numri total i të punësuarve në sektorët që mbulohej nga Komuna e Istogut

Sektorët	Numri
Komuna e Istogut	157
Arsimi fillor dhe i mesëm	618
Çerdhet	43
Shëndetësia	123
<b>Totali</b>	<b>941</b>

Tabela nr.16: Disa nga investimet në shkollat e Istogut gjatë periudhës 2010 -2012

Investimet	Shuma (euro)
Vendosja e aparatit pompues për ngrohjen qendrore në shkollën	7.274

“Mehmet Akif” në fshatin Shushicë	
Ndërtimi i shkollës fillore në Studenicë	77.470
Ndërrimi i dyerve në shkollën e mesme “Mithat Frasheri”	4.997
Vendosja e aparatit pompues për ngrohjen qendrore në shkollën “Martin Camaj” në Gurrakoc	12.720
Ndërtimi i rrethojës në shkollën fillore “Trepça”	22.898
Gëlqerosja e objektit shkollorë “Bajram Curri”	19.682
Renovimi i kulmit në shkollën “Hysni Zajmi” në Vrellë	13.120
Renovimi i brendshëm i shkollës “Mehmet Akif”	19.631
Renovimi i brendshëm i shkollës “Bajram Curri”	70.467
Renovimi i brendshëm i shkollës “Martin Camaj” paralelja në Llukavc	15.310
Renovimi i gjimnazit “Haxhi Zeka” në Istog	24.695
Renovimi i shkollës “Avni Rustemi” në Zallq	93.965
Ndërtimi i aneksit të shkollës fillore në fshatin Padalishtë	14.995
Rregullimi i oborrit dhe vendosja e rrethojave në shkollën “Zymer Zeka”	19.694
Renovimi i shkollës fillore në fshatin Veriq	21.445
Rregullimi i ambientit të jashtëm në shkollën “Nder Mjeda” Rakosh	18.960

## 8. Transparenca e Komunës së Istogut

Komuna e Istogut, në tri vitet e fundit, ka përmirësuar dukshëm transparencën komunale shikuar nga publikimet dhe azhurnimet në faqen zyrtare. Faqja zyrtare posedon materiale dhe informata të shumëllojshme për shumicën e sferave që mbulon Komuna. Njëherazi janë të publikuara edhe raportet financiare të këtij institucioni, si në lëminë e të hyrave ashtu edhe atë të shpenzimeve të parasë publike. Pasqyrimi i këtyre raporteve është bërë në mënyrë periodike, tre, gjashtë, nëntë mujore dhe vjetore. E kënaqshme ka qenë edhe përgjigja e zyrtarëve të komunës në kërkesat e Institutit GAP për qasje në dokumentet publike.

Korrespondentët që mbulojnë zhvillimet në këtë komunë për mediat e ndryshme nuk kanë shfaqur ndonjë pakënaqësi në lidhje me qasjen në informata në sektor të ndryshëm në Komunën e Istogut.

Tabela: nr.17: Vlerësim i përmbajtjes së faqes zyrtare të Komunës së Istogut

<http://kk.rks-gov.net/istog/>

Dokumenti	2010				2011				2012			
	I	II	III	IV	I	II	III	IV	I	II	III	I V
Raporti i Punës së Kryetarit	x	x	x	x	x	√	x	√	x	√	x	√
Raporti financiar (buxhetor) i Komunës	x	√	x	√	√	√	√	√	√	√	x	x
Raportet e Drejtorisë së Administratës	x	x	x	√	x	√	x	√	x	x	x	√
Raportet e Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës	x	x	x	√	x	x	x	√	x	x	x	√
Raportet e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale	x	x	x	√	x	x	x	√	x	x	x	√
Drejtoria për Financa dhe Ekonomi	x	x	x	√	x	x	x	√	x	x	x	√
Drejtoria Urbanizimit, Gjeodezi dhe Kadastër	x	x	x	√	x	x	x	√	x	x	x	√
Drejtoria për Shërbime Publike	x	x	x	√	x	x	x	√	x	x	x	√
Drejtoria e Inspektionit	x	x	x	√	x	x	x	√	x	x	x	√
Drejtoria e Bujqësisë	x	x	x	√	x	x	x	√	x	X	x	√
Zyra e Prokurimit			√				√				x	
Raportet e Njësisë së Auditimit të Brendshëm			x				x				x	
Procesverbalet e Kuvendit Komunal			√				√				√	
Rregulloret Komunale			√				√				√	
Vendimet e Kuvendit Komunal			√				√				√	
Rregullorja e Punës së Kuvendit							√					
Planet dhe Strategjitë e Komunës							√					

X = mungon raporti.

√ = raporti është i publikuar në ueb-faqe.

## 9. Përbushja e premtimeve të fushatës zgjedhore 2009

Gjatë fushatës zgjedhore 2010 kandidati për kryetar komune, tani Kryetari i Komunës z.Haki Rugova, para elektoratit të tij ka shpalosur premtime në sfera të ndryshme.

Tabela e mëposhtme vlerëson progresin e arritur në realizimin e premtimeve të dhëna në vitin 2010. Në këtë tabelë janë përfshirë 14 premtime të dhëna. Në bazë të

hulumtimit të GAP del se pas tri viteve të qeverisjes në Komunën e Istogut, 7 premtime janë përbushur, 3 tjera nuk janë përbushur, ndërsa në 3 premtime ka pasur nisma dhe rezultate evidente, por nuk mund të konsiderohen akoma premtime të përbushura. Një premtim nuk ka qenë i mundur të vlerësohet, për shkak që premtimi ka qenë i gjeneralizuar dhe mungesa e fokusit e ka bërë të pamundur vlerësimin.

Premtimet e 2009	Realizimi 2010-2012
Angazhim në mirëqenien dhe prosperitetin e qytetarëve.	Kjo është vështirë e matshme. Autoritetet komunale rregullimin e infrastrukturës dhe investimet në sferat e tjera e marrin si rritje e prosperitetit dhe mirëqenies së qytetarëve. Por shikuar nga pikëpamja ekonomike, banorët e Istogut përballen me të njëjtën zymtësi sikur para zgjedhjeve lokale të vitit 2009.
Qeverisje të re dhe më efikase.	Istogu që nga pas lufta udhëhiqet nga partia LDK-së dhe termi 'qeverisja të re' bje ndesh me pohimet e udhëheqëseve të kësaj komune që qeverisja ka pasur njëtrajtshmëri gjatë dukatës së fundit. Qeverisja në Komunën e Istogut gjatë tri viteve të fundit ka qenë më dinamike dhe në disa raste me efikase me qeverisjet e mëhershme. Ky premtim vlerësohet përgjithësisht i përbushur.
Realizimin të gjitha kërkesave të qytetarëve të komunës gjatë mandatit katër vjeçar.	Kërkesat e qytetarëve janë të ndryshme dhe mundësia e autoriteteve komunale për t'i përbushur gjitha ato mbetet e kufizuar. Dhënia e një premtimi të tillë vlerësohet si eufori/entuziazëm zgjedhor. Shembull për këtë mund të merret demet që janë shkaktuar nga era e fuqishme që pati përfshirë Istogun vjeshtën e vitit 2011 ku vlerësimet kane dal që shkalla e dëmeve është afro 6 milionë euro, ndërsa komuna ka ofruar për sanimin e

	tyre me pak se 200 mijë euro. Premtim i pa përmbushur.
Vazhdimin e realizimit të projekteve të filluara.	Premtim i përmbushur. Nuk është hasur ndonjë projekt i nisur në terren para fushatës zgjedhore që nuk është përmbyllur gjatë vitit të parë të mandatit.
Infrastrukturë rrugore më të mirë.	Shtrimi i rrugëve në Istog bëhet përgjithësisht pa pasur plane detaje të hartuara. Bëhen vetëm planet at/hoc ku përfshihet gjatësia, gjerësia, lokacioni dhe kostoja. Njëra nga çështjet që me se shumti është ngritur nga partitë opozitare në Kuvendin e Istogut ka konsistuar me cilësinë jo të mirë të punëve që fillohen nga komuna. Shikuar në tërësi, infrastruktura rrugore është dukshëm më e mirë se katër vite më herët. Asociacioni i Komunave të Kosovës në vitin 2012 i ka ndarë një çmim kësaj komune për cilësinë dhe sasinë e rrugëve të rregulluara. Ky premtim mund të merret përgjithësisht i përmbushur, ndonëse mbetet akoma të bëhet në sferën e infrastrukturës dhe forcimit të mekanizmave në kontrollimin e punëve në terren.
Ndërtim të kanalizimit dhe ujësjellësit.	Ka pasur një ecuri progresive në këtë drejtim. Është ndërtuar në tri faza kanalizimi në fshatin Tomoc. Në dy faza është kryer kanalizimi edhe në fshatin Vrelle dhe Sudenic. Po ashtu ka përfunduar me tri faza ndërtimi i kanalizimit në fshatin Banjë. Kanalizimi është ndërtuar edhe në lagjen e quajtur "Lugut" dhe përgjatë zonave urbane të qytetit. Komuna e Istogut edhe në të kaluarën nuk ka pasur probleme evidente me rrjetin dhe burimet e ujit dhe kësaj nuk është paraqitur e nevojshme investimet e shumta në këtë sferë. Premtim i përmbushur.
Arsim cilësor.	Nuk ka pasur ndonjë projekt, apo nismë konkrete komunale për të matur cilësi e arsimimit. Investimet në ndërtimin/riparimin e shkollave merren nga zyrtarët komunal si rritje të cilësisë në arsim, por kjo ndikon dhe duhet kuptuar vetëm si përmirësim i kushteve, por jo edhe i cilësisë. Shikuar nga rezultatet e testit të maturës ato varësisht nga vitet shënojnë rënie dhe ngritje. Ky premtim vlerësohet pjesërisht i përmbushur.

Investime në bujqësi.	Ka pasur një ecuri progresive në këtë fushë. Për çdo vit është pastruar nga komuna, kanali për ujitjen e tokave bujqësore. Po ashtu është bërë kullimi i tokave bujqësore, investim nga komuna. Janë blerë nga komuna fidanë për ngritjen e pemishteve të reja. Është rregulluar penda e ujit në fshatin Dobovë. Premtim i përmbushur.
Shëndetësi më të mire.	Niveli i shërbimeve në shëndetësi nuk dallon nga koha e para fushatës zgjedhore. Ndonëse ka pasur investime inkurajuese ne QKMF dhe në QMF në vendbanime të ndryshme. Premtim i pa përmbushur.
Ekonomi të vogël të zhvilluar.	Istogu nuk ka një zonë të ashtuquajtur industriale apo tregtare. Bizneset janë të shpërndara. Nuk ka pasur ndonjë projekt komunal i cili ekskluzivisht i është dedikuar kësaj kategorie të ekonomisë së vendit. Premtim i pa përmbushur.
Realizimin e shume projekteve për rininë e Istogut.	Nga buxheti i 2011 janë dhënë rreth 35.000 euro për përkrahjen e projekteve/nismave. Komuna po ashtu nga buxheti i saj ndan për çdo vit mjete për organizimin e ashtuquajturës kampi veror i rinisë ku te rinjtë nga organizatat, shkollat dhe nisma tjera mblidhen dhe diskutojnë për problemet dhe gjetjen e alternativave për zgjidhjen e tyre. Premtim i përmbushur.
Për fshatin Vrellë sallë sportive në kuadër të shkollës fillore të fshatit si dhe ndriçimin publik.	Fshati nuk ka ndriçim publik, ndërsa salla e sporteve akoma nuk është përfunduar/ ka nisur së ndërtuari. Premtim pjesërisht i përmbushur.
Për Banjën shndërrimin e Banjës në qendër turistike bashkëkohore, asfaltimin e rrugicave nëpër të gjitha lagjet, si dhe objekt të ri shkollor.	Nuk ka pasur nisma konkrete komunale për zhvillimin dhe inkurajimin e turizmit. Rrugët lokale vlerësohet përgjithësisht të shtruara. Premtim pjesërisht i përmbushur.
Për fshatin Shushicë shtrirjen e kanalizimit, largimi i ujërave të zeza dhe renovimin objektit shkollor.	Këto janë realizuar. Premtim i përmbushur.

## 10. Burimet

1. Komuna e Istogut. Zyra e Kryetarit. Raporti i Punës së Komunës së Istogut për Vitin 2011. Burimi: [http://kk.rks-gov.net/istog/getattachment/Municipality/President/President-Report/Raporti-DETAL\\_janar\\_dhjetor\\_2011.pdf.aspx](http://kk.rks-gov.net/istog/getattachment/Municipality/President/President-Report/Raporti-DETAL_janar_dhjetor_2011.pdf.aspx)
2. Komuna e Istogut. Zyra e Kryetarit. Raporti i Punës së Komunës së Istogut për Vitin 2012. Burimi: [http://kk.rks-gov.net/istog/getattachment/Municipality/President/President-Report/Raporti\\_janar\\_dhjetor\\_2012\\_tubimi\\_qytetar-Autosaved\\_.pdf.aspx](http://kk.rks-gov.net/istog/getattachment/Municipality/President/President-Report/Raporti_janar_dhjetor_2012_tubimi_qytetar-Autosaved_.pdf.aspx)
3. Komuna e Istogut. Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim. Raporti Financiar janar – dhjetor 2011. <http://kk.rks-gov.net/istog/Reguloret-dhe-Pasqyrat-Komunale.aspx>
4. Komuna e Istogut. Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim. Raporti Financiar janar – dhjetor 2012.
5. Komuna e Istogut. Drejtoria e Administratës. Lista e të punësuarve në administratë.
6. Komuna e Istogut. Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale. Lista e të punësuarve në sektorin e shëndetësisë primare.
7. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Rezultatet e zgjedhjeve për Kryetar të Komunave. 2009. Burimi: <http://www.kqz-ks.org/SKQZ-WEB/al/zgjedhjetekosoves/materiale/rezultatet2009/kryetar/results%20by%20municipality%20.pdf>
8. Komuna e Istogut. Plani Zhvillimor Komunal i Istogut. Burimi: [http://kk.rks-gov.net/istog/getattachment/f961324e-8e77-44a8-8d18-34caf3f6ab04/PRRU-ISTOG-\\_PJESA-TEKSTUALE-pdf.aspx](http://kk.rks-gov.net/istog/getattachment/f961324e-8e77-44a8-8d18-34caf3f6ab04/PRRU-ISTOG-_PJESA-TEKSTUALE-pdf.aspx)
9. Agjencia e Statistikave të Kosovës. Rezultatet përfundimtare për Regjistrimin e Popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave - 2011. Burimi: [http://esk.rks-gov.net/rekos2011/repository/docs/Te%20dhenat%20kryesore\\_ALB.pdf](http://esk.rks-gov.net/rekos2011/repository/docs/Te%20dhenat%20kryesore_ALB.pdf)
10. Kuvendi i Kosovës. Ligji për Financat e Pushtetit Lokal. Burimi: [http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2008\\_03-L049\\_al.pdf](http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2008_03-L049_al.pdf)
11. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm. Raporti i Auditimit Financiar për Komunën e Istogut. 2011. Burimi: [http://www.oag-rks.org/repository/docs/Raporti\\_Istog\\_ALB\\_me\\_PVF\\_491736.pdf](http://www.oag-rks.org/repository/docs/Raporti_Istog_ALB_me_PVF_491736.pdf)
12. Instituti për Studime të Avancuara GAP. Si i shpenzon shteti paret tona. Komuna e Istogut. Burimi: [http://www.institutigap.org/spendings/?istog/2013#/~/\\_istog](http://www.institutigap.org/spendings/?istog/2013#/~/_istog)
13. Komuna e Istogut. Kuvendi Komunal. Procesverbali nga mbledhja e Kuvendit Komunal të Istogut. Nr 28. Datë 31.01.2012. Numri rendor në faqen zyrtare të komunës 2/23/2012/2:58. Burimi: <http://kk.rks-gov.net/istog/Municipality/Seances.aspx>
14. Komuna e Istogut. Kuvendi Komunal. Procesverbali nga mbledhja e Kuvendit Komunal të Istogut. Nr 33. Datë 28.05.2012. Numri rendor në faqen zyrtare të komunës 6/25/2012/7:06. Burimi: <http://kk.rks-gov.net/istog/Municipality/Seances.aspx>



15. Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik. Njoftimet e shpallura për dhënien të tenderit. Komuna e Istogut. Burimi: <https://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=-1&CtlID=ViewNotices&ID=40139>
16. Agjencia Kundër Korrupsionit. Deklarimi i Pasurisë. 2011. Komuna e Istogut. Haki Rugova. Burimi: [http://akk-ks.org/2011/Komunat\\_e\\_Kosoves/Komuna\\_Istog/Haki\\_Rugova.pdf](http://akk-ks.org/2011/Komunat_e_Kosoves/Komuna_Istog/Haki_Rugova.pdf)
17. Organi Shqyrtues i Prokurimit. Vendimet e shpallura për Komunën e Istogut. Burimi: <http://oshp.rks-gov.net/>
18. Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë. Statistikat e Arsimit në Kosovë 2011. Burimi: <http://www.masht-gov.net/advCms/documents/11052012.pdf>
19. Kuvendi i Kosovës. Ligji për Ndarjen e kufijve Administrativ të Komunave. Nr.03/L-041. Burimi: [http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2008\\_03-L041\\_al.pdf](http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2008_03-L041_al.pdf)
20. Komuna e Istogut. Faqja Zyrtare. Burimi: <http://kk.rks-gov.net/istog/Home.aspx>
21. Qeveria e Kosovës. Ministria e Financave. Tabelat e Buxhetit të Kosovës për vitin 2011. Burimi: <http://mf.rks-gov.net/sql/ministriaefinancave/buxhetiirepublikesekosoves/buxhetiqendrore.aspx>